

VENDIM
Nr. 110, datë 1.12.2022

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR NDËRMARRJET SOCIALE”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Delina Ibrahimaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Brikena Qela	anëtare;
Z. Ahmet Maçellari	anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 1.12.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 22.8.2022, “Për Ndihmën Shtetërore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 4262, datë 3.11.2022, njoftimin e ndihmës për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet subvencionit nga buxheti i shtetit i veprimtarisë së tyre;

Qëllimi i skemës: Skema synon mbështetjen për integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, përmes rregullimit të formave të mbështetjes të ndërmarrjeve sociale;

Baza ligjore për njoftimin e ndihmës: Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”, të parashikuar në nenin 26/2, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe:

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës do të jenë ndërmarrjet sociale. Ndihma do të jepet në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit me vlerë të përgjithshme prej 360,000,000 lekësh dhe skema do të ketë një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tre) vjetësh, për periudhën 2022–2025;

2. Ndihma për një ndërmarrje sociale propozohet se nuk do të kalojë shumën 14,000,000 lekë (ndihma *de minimis*). Për këtë ndërmarrje plotëson deklaratën për çdo ndihmë *de minimis*, të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, të përfituar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitin financiar në vazhdim;

3. Dhënës i ndihmës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

4. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Në kuptim të legjislacionit të ndihmës shtetërore çdo njësi ekonomike e angazhuar në një aktivitet ekonomik (ofrimi i mallrave dhe shërbimeve në një treg të caktuar) konsiderohet si një ndërmarrje, pavarësisht formës ligjore ose mënyrës së financimit. Pra ndërmarrjet sociale konsiderohen si ndërmarrje të angazhuara në një aktivitet ekonomik;

- Ndihma aktivizon burime shtetërore (nga buxheti i shtetit) në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar;

- Skema është selektive, sepse ndihma do të jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh sociale;

- Skema ka efekt nxitës, pasi ndërmarrjet sociale do të aplikojnë për të përfituar nga skema dhe ka impakt në treg,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 10, 22, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore të parashikuar në projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”, mbështetur në nenin 10, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

2. Intensiteti i ndihmës për kompensimin e kostove shtesë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të tejkalojë 100% të kostove të pranueshme, të parashikuar në nenin 20, të VKM-së nr. 513/2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”.

3. Ministri përgjegjës për mbrojtjen sociale, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Ministri përgjegjës për mbrojtjen sociale të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.

5. Ministri përgjegjës për mbrojtjen sociale të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë, në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj